



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Rezultanti i datës	14. 10. 2021		
Nr. e faksimile	Numri	Sip. po	Vazh.
	0112419		



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet

UNIVERSITETIT PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN

dhe projektit

ARSIMI I LARTË, HULUMTIM DHE SHKENCAT E APLIKUARA PLUS

Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Bajram KOSUMI (në tekstin e mëtejmë UKZ),

Projekti “**ARSIMI I LARTË, HULUMTIM DHE SHKENCAT E APLIKUARA PLUS**”, në tekstin e mëtejmë i referuar si “**HERAS+**”,

Dhe së bashku të referuar si “**Palët**”,

Preambulë

UKZ

Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan është një institucion me identitet dhe autonomi juridike, në përputhje me Ligjin për Arsimin Universitar të Kosovës nr. 04 / L-037, dhe nenin 25, 216, 217, 218, 219 të Statutit të Universitetit " Kadri Zeka ", miratuar nga Parlamenti i Kosovës më 10 dhjetor 2020. UKZ, përmes kësaj marrëveshje ka për qëllim krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis dy institacioneve, veçanërisht për zhvillimin e shkëmbimeve akademike dhe kulturore përmes ndihmës së ndërsjellë në fushat e arsimit, kërkimit dhe të tjera.



HERAS+

HERAS+ synon të bëjë sektorin publik të arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore më konkurruesh dhe më të larmishëm në Kosovë në përputhje me Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), Zonën Evropiane të Kërkimeve shkencore (ERA) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) 4 dhe 9 që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë, ekonominë dhe rëndësinë e tregut të punës, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe me dimensionin social të arsimit të lartë. Projekti kontribuon në sistemin e arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore në Kosovë në mënyrë që të qeveriset më mirë, të ndërkombëtarizohet më shumë, të jetë koherent, efektiv dhe efikas, duke e nxitur punësimin e studentëve dhe misionin e tretë të universiteteve.

Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fonde të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC), dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës (MASH). HERAS+ implementohet nga një konzorcium austriak me përvojë përfaqësuar nga Shërbimi Botëror i Universitetit të Austrisë (WUS Austria) si udhëheqës i konzorciumit, duke përfshirë Qendrën për Inovacionin Social (ZSI) si dhe Agjencinë Austriake për Mobilitetin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Arsim, Shkencë dhe Hulumtim (OeAD). Periudha e zbatimit të projektit HERAS+ është nga Qershor 2020 deri në Maj 2023.

Palët pajtohen si më poshtë:

Neni 1

Ky memorandum është përgatitur si vazhdë e takimeve fillestare në mes përfaqësueseve zyrtarë të UKZ-së dhe HERAS+.

Neni 2

Dokumentet e referuara të cilat përkufizojnë aktivitetet e përbashkëta të prezantuara në dokumentin strategjik të UKZ-së, si dhe në studimin "*baseline assessment*" i cili do të zhvillohet në bashkëpunim të afërt në mes palëve.

Neni 3

Përgjegjësitë dhe aktivitetet e ndërmarra nga UKZ-së janë:

1. Të emërojë një person kontaktues (shih Nenin 9) që do të jetë përgjegjës për komunikimin e përditshëm me HERAS+ në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta;
2. Pjesëmarrje aktive në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta;
3. Të ofrojë qasje në informata dhe dokumente përkatëse për zhvillimin e dokumentit strategjik dhe "*baseline assessment*" të Universitetit;



4. Udhëheqë organizimin e eventeve dhe punëtorive përkatëse, d.m.th. përgatitë listën e pjesëmarrësve, dërgon agjendën dhe ftesat, bashkë-moderon ngjarjet së bashku me Ekipin HERAS+ ose ekspertët e caktuar;
5. Takohet rregullisht me zyrtarët dhe ekspertët e ekipit HERAS+, si dhe informon ekipin e HERAS+ paraprakisht në rast të ndryshimeve në lidhje me organizmin e eventeve.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe aktivitetet e ndërmarra nga HERAS+ janë:

1. Të emërojë një person kontaktues (shih Nenin 9) që do të jetë përgjegjës për komunikimin e përditshëm me UKZ-në në zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta;
2. Të sigurojë mbështetje të ekspertëve lidhur me implementimin e fushave specifike për strategjinë e UKZ-së, në veçanti në fushat lidhur me zhvillimin universitar, sigurimin e cilësisë, hulumtimit dhe inovacionit, dhe ngjashëm;
3. Të ofrojë mbështetje për implementimin e rekomandimeve nga vlerësimi bazë¹;
4. Pjesëmarrje aktive në grupet punuese të themeluara nga UKZ për draftimin, rishikimin dhe implementimin e aktiviteteve e vazdueshme të përbashkëta;
5. Informacioni dhe dokumentet e UKZ-së nuk do të ndahen me palët e treta dhe HERAS+ në bazë të kërkesës do të ruajë konfidencialitetin e informatave.

Neni 5

Aktivitetet e cekura në Nenin 4, do të menaxhohen dhe financohen plotësisht nga HERAS+, përfshirë shpenzimet e ekspertëve të angazhuar, shpenzimet që ndërlidhen me organizmin e ngjarjeve, d.m.th. salla e ngjarjeve, pijet freskuese dhe vaktet, mbështetjen teknike, shpenzimet e transportit (nëse vendndodhja është jashtë Gjilanit) në përputhje me normat dhe kushtet e projektit HERAS+.

Neni 6

UKZ do të informojë menjëherë ekipin e HERAS+, për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose kërcënon të ndërhyjë në ritmin e zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.

¹ Mbështetja financiare është përcaktuar për Universitetin dhe do të sigurohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e HERAS + dhe drejtohet/menaxhohet nga partneri kryesor i konzorciumit (WUS Austria). Mbështetja lidhet kryesisht me ekspertizën kombëtare/ndërkombëtare, punëtoritë, rishikimet, kostot për evenetet dhe të ngjashme.



Neni 7

Nenet e këtij memorandumi mund të ndryshohen ose amandamentohen me marrëveshje të ndërsjellë përmes shkëmbimit të korrespondencës me shkrim, me kusht që ndryshimet ose amandamentimet e tillë të mos ndikojnë në qëllimin afatgjatë të memorandumit dhe partneritetit midis Universitetit dhe HERAS+.

Neni 8

Memorandumi mund të përfundohet para datës së skadimit (shih Nenin 12) nga marrëveshje e përbashkët mes palëve. Përveç kësaj, secila palë ka të drejtën të tërhiqet nga ky memorandum duke e njoftuar palën tjetër të paktën tre muaj paraprakisht.

Neni 9

Të gjitha korrespondencat, kërkesat, porositë ose komunikimet e tjera do të konsiderohen të vlefshme, përderisa ato transmetohen përmes letrave, postës, e-mail ose me ndonjë mjet tjetër, në formë të shkruar, tek personat përgjegjës si në vijim:

Për UKZ-në:

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Email: dukagjin.leka@uni-gjilan.net
Tel. +383 44 211 671

Për HERAS+:

Z. Nehat Dervishi, Koordinator për Arsimin e Lartë
E-mail: nehat.dervishi@wus-austria.org
Tel. +383 38 241 472

Neni 10

Asnjëra palë në këtë marrëveshje nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat ose dështimet për të kryer ndonjë detyrim sipas kësaj marrëveshje për shkak të akteve të natyrës, pandemisë, grevave ose shqetësimeve të tjera, pa kufizime, luftës, akteve terroriste, kryengritjeve, embargove, kufizimeve qeveritare, akteve të qeverive ose autoriteteve qeveritare, dhe çdo shkaku tjetër përtej kontrollit të palëve.



Neni 11

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit ose interpretimit të këtij memorandumi do të zgjidhet me anë të konsultimit ndërmjet palëve kontraktuese. Palët në këtë marrëveshje do të përpiken të zgjidhin në mënyrë miqësore, përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe marrëveshjeve reciproke, çdo mosmarrëveshje ose ankesë në lidhje me interpretimin, zbatimin ose përbushjen e kësaj marrëveshjeje. Asnjë masë ligjore nuk parashikohet në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen sipas këtij nenit.

Neni 12

Ky memorandum hyn në fuqi në datën në të cilën pala e fundit nënshkruan dhe do të mbetet në fuqi deri në fund të projektit (Maj 2023).


Bërë në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe angleze, të dy tekstet janë të barabarta dhe autentike.

Nënshkruar në Gjilan më 14.10.2021

Nënshkruar në Gjilan më 14/10/2021

Në emër të Universitetit "Kadri Zeka"

Në emër të HERAS Plus


Prof. Dr. Bajram Kosumi
Rektor




Z. Aqim Emurli
Lider i Ekipit